

**INDIKATORËT E PËRHAPJES SË
KORRUPSIONIT NË SISTEMIN
E DREJTËSISË NË KOSOVË**

**INDICATORS OF THE SPREAD OF
CORRUPTION IN KOSOVO'S
JUDICIAL SYSTEM**



Personeli:

Ismet KRYEZIU - Drejtor ekzekutiv
email: ikryeziu@kdi-kosova.org

Vjollca VOGËL - Menaxhere e administratës dhe financave
email: vjollca@kdi-kosova.org

Leonora CIKAJ - Asistente për administratë dhe financa
email: lcikaj@kdi-kosova.org

Programi - Transparenca dhe Antikorrupsioni

Merita MUSTAFA - Menaxhere e programit
email: mmustafa@kdi-kosova.org

Admir ISTREFI - Asistent Programi
email: aistrefi@kdi-kosova.org

Besnik RAMADANAJ - Zyrtar për marrëdhënie me publikun
email: bramadanaj@kdi-kosova.org

Sahit BIBAJ - Avokat / Këshilltar juridik
email: sbibaj@kdi-kosova.org

Natyra KASUMAJ - Vullnetare
email: nkasumaj@kdi-kosova.org

Visar RAMAJ - Vullnetar
email: vramaj@kdi-kosova.org

Liridon SELMANI - Monitorues
email: lselmani@kdi-kosova.org

Programi - Qeverisja Qendrore:

Valmir ISMAILI - Menaxher programi
email: vismaili@kdi-kosova.org

Driton SELMANAJ - Asistent i programit
email: dselmanaj@kdi-kosova.org

Fitore ZENELI - Asistente e programit
email: fzeneli@kdi-kosova.org

Isuf ZEJNA - Monitorues
email: izejna@kdi-kosova.org

Ramadan KLISURICA - Monitorues
email: rklisurica@kdi-kosova.org

Rrezarta AHMETI - Monitorues
email: rrahmeti@kdi-kosova.org

Programi - Qeverisja Lokale

Naim CAHANAJ - Menaxher programi
email: ncahanaj@kdi-kosova.org

Nora VESELI - Koordinator
email: nveseli@kdi-kosova.org

Bashkëpunëtor të jashtëm

Arsim GJINOVCI - IT & design
email: agjinovci@kdi-kosova.org

Yll BULESHKAJ - Analist
email: ybuleshkaj@kdi-kosova.org

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	5
Mbi indikatorët e përhapjes së korrupsionit në sistemit gjyqësor në Kosovë.....	6
Grumbullimi i lëndëve dhe numri i gjyqtarëve.....	6
Ndarja e rasteve mes gjyqtarëve dhe menaxhimi lëndëve.....	9
Procedimi i lëndëve lidhur me korrupsionin.....	11
Roli prokurorive në seancat gjyqësore dhe rezultatet e tyre.....	13
Profesionalizmi i gjyqtarëve.....	14
Rregullsia e mbajtjes së seancave gjyqësore.....	16
Kontrolli ndaj gjyqësorit.....	17
Këshilli Gjyqësor i Kosovës.....	17
Vlerësimi i punës së gjyqtarëve.....	19
Deklarimi dhe kontrolli i pasurisë.....	19
Transparenca.....	20
Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve.....	20
Përfundim.....	21
Literatura e përdorur.....	22

HYRJE

Në Kosovën e pasluftës ka pasur një intenzitet të zhvillimeve për ndërtimin e sistemit demokratik të shtetit. Prezenca ndërkombëtare në krijimin dhe administrimin e institucioneve shtetërore, ka pasur një ndikim të madh për sa i përket marrjes së vendimeve të rëndësishme, e sidomos vendimeve që kanë pasur të bëjnë me pakicat jo shqiptare.

Mungesa e vullnetit politik dhe gadishmëria e dobët e institucioneve akoma egzistojnë për të ju qasur më seriozisht luftës kundër korrupsionit, ku edhe sot mungojnë ligjet dhe mekanizmat e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit.

Sistemi gjyqësor duhet të jetë një ndër institucionet më kredibile të një vendi, po ashtu duhet të jetë plotësisht i pavarur nga ndikimet e jashtme, qofshin ato politike, individuale apo ekonomike. Integriteti dhe pavarësia e sistemit gjyqësor janë të një rëndësie të veçantë në rastet kur trajtohet korrupsioni dhe po ashtu rrisin efikasitetin e gjyqësorit. Pavarësia e gjyqësorit len të kuptohet që gjyqtarët, prokurorët dhe punëtorët e tjerë të administratës nuk duhet të jenë nën ndikimet e jashtme, qoftë të politikës, pushtetit apo interesave tjera individuale. Por, kjo gjithashtu nuk do të thotë që kjo pavarësi i lejon të njëjtit të sillen dhe të veprojnë sipas dëshirave dhe interesave të tyre.

Edhe për kundër zhvillimeve të arritura të Kosovës në ndërtimin e institucioneve, sistemi gjyqësor ka ngecur për sa i përket funksionimit demokratik dhe transparent të tij. Nga raportet dhe analizat e bëra për sistemin gjyqësor, si nga organizatat vendore poashtu edhe ato ndërkombëtare, gjyqësinë e paraqesin në një gjendje të brishtë dhe jo të fuqishme sa i përket luftimit të korrupsionit dhe transparencës së funksionimit të saj.

Një ndër problemet e shumëta që e bëjnë sistemin gjyqësor jo efikas, është edhe mungesa e kompletimit të legjislacionit. Në mungesë të ligjit për gjykata, janë krijuar paqartësi të bartjes së kompetencave në mes të gjykatave, prokurorisë dhe këshillit gjyqësor, për administrim të mirëfillt të vetë sistemit gjyqësor në Kosovë.

Rritja e efikasitetit të punës në sistemin gjyqësor zvogëlon mundësitë e korrupsionit në të gjitha procedurat gjyqësore, jo vetëm të atyre që merren me korrupsionin. Prandaj, indikatorët e efikasitetit në sistemin gjyqësor nuk dallojnë nga llojet e rasteve që trajtohen, por fokusohen në gjetjen e volumit të rasteve që kalojnë përmes sistemit. Një strukturë mbështetëse ligjore dhe kapacitet i fortë i sistemit gjyqësor në formën e alokimeve adekuate buxhetore, numër i mjaftueshëm i stafit, trajnime të duhura për stafin dhe menaxhim i mirë i lëndëve në gjykata, të gjitha këto ndihmojnë në rritjen e efikasitetit.¹

¹ Indicators of Judicial Efficiency in Corruption Cases- U4 Expert Answer

NË PËRGJITHËSI MBI INDIKATORËT E PËRHAPJES SË KORRUPSIONIT NË SISTEMIT GJYQËSOR NË KOSOVË

1. Grumbullimi i lëndëve dhe numri i gjyqtarëve

Sistemi gjyqësor në Kosovë njërin prej problemeve akute e ka grumbullimin e madh të rasteve dhe mos-zgjidhjen e tyre. Përveq trashëgimit të një numëri të madh të rasteve nga vitet e kaluara karakteristike është se sistemi gjyqësor në përgjithësi për asnjë vit nuk po arrin të zgjidh të gjitha rastet që i drejtohen atij gjatë vitit. Pra, për çdo vit kemi: bartje të lëndëve që nuk janë zgjidhur në vitin prezent nga gjykata, lëndë nga vitet e kaluara, dhe bartjen nga vitit prezent në vitin e ardhshëm. Sipas të dhënave të Departamentit të Statistikës pranë Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me punën dhe efikasitetin e gjykatave të rregullta kemi këto të dhëna:

	Numri i lëndëve të pranuar në vitin 2008	Numri i lëndëve të trashëguara nga 2007	Numri i rasteve të kompletuara gjatë vitit 2008	Numri i lëndëve të pakryera në fund të vitit
Gjykata Supreme	3706	2889	4196	2399
Gjykata Ekonomike	1484	588	743	1329
Gjykatat e Qarkut	11363	8993	10003	10353
Gjykatat Komunale	309838	150595	278546	181887
Gjithsejtë gjykatat e rregullta	326391	163065	293488	195968

Tabela 1. Numri i rasteve nëpër gjykata. Marrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. "Raporti vjetor 2008, statistika e gjykatave të rregullta".

Siç shihet nga shifrat e prezantuara më lartë, efikasiteti i gjyqësorit është në nivel të pakënaqshëm. Kështu nëse analizohet vetëm vitin 2008 lidhur me rastet e pranuar dhe rastet e zgjidhura, atëherë del se vetëm gjykata Supreme ka zgjidhur më shumë raste se sa që i janë paraqitur gjatë vitin 2008. Gjykata Ekonomike ka shkallën më të ulët të efikasitetit, rreth 50% të rasteve ka arritur t'i zgjidh, ku nga 1484 raste të paraqitura ka zgjidhur vetëm 588. Gjykata e Qarkut ka një përqindje të zgjidhjes prej rreth 88% të lëndëve që i janë paraqitur në vitin 2008, dhe Gjykatat Komunale prej rreth 89.9% të lëndëve të zgjidhura.

Tendencë e përafërt shihet edhe në vitin 2009 bazuar në të njëjtin burim. Përpos Gjykatës Supreme që ka numër më të madh të lëndëve të zgjidhura në raport me lëndët e reja, me efikasitet prej 114%, të gjitha Gjykatat tjera të rregullta janë me efikasitet të

ulët, pra me numër më të vogël të lëndëve të zgjidhura në raport me lëndët që i janë drejtuar në atë periudhë. Kështu efikasiteti i Gjykatës Ekonomike është 98%, i Gjykatës së Qarkut 94%, dhe i Gjykatave Komunale 93%.

	Numri i lëndëve të pranuar në gjastë-mujorin e parë 2009	Numri i lëndëve të trashëguara nga 2008	Numri i rasteve të kompletuara gjatë gjastë-mujorit parë 2009	Numri i lëndëve të pakryera në fund të gjastë-mujorit parë 2009
Gjykata Supreme	1702	2399	1941	2160
Gjykata Ekonomike	477	1329	469	1337
Gjykatat e Qarkut	5523	10353	5201	10675
Gjykatat Komunale	185894	177560	173345	190109
Gjithsejtë gjykatat e rregullta	193596	191641	180956	204281

Tabela 2. Numri i rasteve nëpër gjykata. Marrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. “Raporti Gjastë-mujorit të parë 2009, statistika e gjykatave të rregullta”.

Sa u përket arsyeve të një numëri kaq të madh të rasteve të pazgjidhura, përfaqësuesit e gjykatave e arsyetojnë me numër të vogël gjyqtarësh dhe numër të lartë të rasteve. Edhe pse një pohim i tillë qëndron, paraqiten edhe një varg elementesh tjerë që kanë një ndikim shumë të rëndësishëm në numrin kaq të madh të rasteve të pazgjidhura. Disa nga këto elemente janë edhe: mënyra e rregullimit të sistemit gjyqësor dhe prokuroria me ligje sistimore, sistemi i ndarjes së punës mes gjyqtarëve, menaxhimit efikas të rasteve, profesionalizmi, mekanizmat e kontrollit të punës së gjyqtarëve, transparenca në punë, sistemi i përgjegjesisë së gjyqtarëve etj. Pikërisht këto janë elementet që do të analizohen më tutje në raport.

Sipas Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gjegjësisht Departamentit të Statistikës, në publikimin e “Raportit mbi punën e gjykatave gjatë vitit 2008” Kosova ka një numër prej 269 Gjyqtarësh që shërbejnë për një numër prej rreth 2.2 milionë njerëz. Një mënyrë e mirë për ta testuar pohimin se a është vetëm numri i gjyqtarëve që ndikon në efikasitetin e gjyqësorit është krahasimi i numrit të gjyqtarëve për kokë banori në Kosovë me vendet tjera. Kjo bëhet duke llogaritur numrin e gjyqtarëve që shërbejnë për 100.000 banorë. Nga vende të ndryshme kemi këtë pasqyrë:

Numri i gjykatësve për 100.000 banorë	
Korea Jugore	3.3
Shqipëria	7.4
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	9.8
Franca	11.1
Kosova	14.2
Maqedonia	31.1
Rumania	15.7

Tabela 3. Numri i gjykatësve për numër banorëve

Nga tabela lartë shihet se ka vende me sistem shumë efikas gjyqësor që kanë numër shumë më të vogël të gjyqtarëve sikurse është edhe rasti i SHBA-ve, Francës. Në anën tjetër, ndodhet Shqipëria që ka 7.4 gjykatës për 100.000 banorë, gati përgjysmë më pak gjyqtarë për kokë banori se Kosova. Nga këto të dhëna konkludohet se nuk është numri i gjyqtarëve çdo herë faktori i vetëm dhe më i rëndësishëm për një sistem gjyqësor efikas dhe profesional, por ekzistojnë edhe faktorë tjerë, të përmendur më lartë, ndër të cilët me rëndësi të madhe është forma e organizimit të sistemit gjyqësor.

Sa i përket mënyrës së organizimit të sistemit të drejtësisë në Kosovë, tash së fundi është bërë edhe përzgjedhja e një numri kandidatësh të cilët i kanë filluar trajnimet për aplikimin e sistemit të noterisë. Këta kandidatë fillimisht e kanë kaluar fazën e parë të një testimi lidhur me këtë sistem. Të gjitha këto procedura janë bazuar në Ligjin për Noterinë që është në fuqi në Kosovë. Pritet që me aplikimin e këtij sistemi gjykatat të lirohen nga numri i madh i rasteve. Sipas Ligjit mbi Noterinë parashihet që noterët të kenë përgjegjësi në kryerjen e shumë çështjeve jashtë-kontestimore. Pra, ky është një shembull se si në mënyra të ndryshme mund të reformohet sistemi gjyqësor dhe të lirohet nga ngarkesa e madhe.

Qeveria e Kosovës në “Planin për partneritet evropian” në pjesën që ka të bëjë me sistemin Gjyqësor në Kosovë ka paraparë që në afatin kohor të tre mujorit të katërt të vitit 2008 të rritet numri i gjykatësve në 80, në mënyrë që ndër të tjera të rritet edhe efikasiteti i Gjykatave. Kjo rritje jo që nuk është bërë, por përkundrazi numri i gjyqtarëve aktual që punojnë në sistemin Gjyqësor të Kosovës vetëm është zvogëluar. Gjatë muajve të fundit, e sidomos pas testit të Etikës, test i cili bën pjesë në fazën e riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve ekzistues dhe emërimit të anëtarëve të rinj, një numër në rritje i gjyqtarëve kanë dhënë dorëheqje duke bërë që gjendja ekzistuese të jetë edhe më e rëndë.

2. Ndarja e rasteve mes gjyqtarëve dhe menaxhimi lëndëve

Elementet që do të ndikonin në efikasitetin dhe llogaridhënien e gjyqësorit janë edhe ekzistimi i një sistemi të paanshëm dhe transparent gjatë ndarjes së rasteve mes gjyqtarëve dhe menaxhimit elektronik të rasteve. Këto elemente kanë rëndësinë e tyre po ashtu edhe në respektimin e parimeve bazë të punës së gjyqësorit që janë pavarësia e tij nga ndikimet e ndryshme të jashtme dhe të brendshme dhe objektiviteti e profesionalizmi. Sistemi gjyqësor në Kosovë karakterizohet pikërisht me parregullsi të mëdha në këtë fushë, ku si shembull lëndët nga lëmia e njëjtë të dorëzuara në vitin 2009 zgjidhen po në këtë periudhë derisa lëndët e viteve të mëhershme ende presin.

Në sistemin gjyqësor të Kosovës edhe pse do të duhej të ketë një sistem të kriterëve në bazë të të cilave bëhet shpërndarja e rasteve tek gjyqtarët, raportet e EULEX-it që merren me monitorim të punës gjykatave² pohojnë se implementimi i një sistemit tillë është shumë i dobët. Sistemi i ndarjes së lëndëve mes gjyqtarëve është i rregulluar nga vetë gjykatat e caktuara.

Kështu praktikohen një laramani sistemesh të ndarjes së lëndëve mes gjyqtarëve ku bëjnë pjesë: sistemi i ndarjes çift-tek, sistemi me alfabet, sistemi i ndarjes bazuar në një numër lëndësh me radhë që shkojnë tek një gjyqtar e pastaj radha tjetër tek tjetri, caktimi i lëndëve nga vetë kryetari i gjykatës përkatëse etj. Asnjë nga këto sisteme të lartpërmendura nuk është i duhuri për të siguruar se rastet nuk do të caktohen në mënyrë preferenciale apo pa ndikime tek gjyqtari i caktuar, pasi tek të gjithat sistemet ka mekanizma që lejojnë mundësi të caktimit të një lënde tek gjyqtari i caktuar. E njëjta situatë është e pranishme edhe në prokuroritë publike.

Tek sistemi i ndarjes së lëndëve çift-tek, ekziston mundësia që personeli i gjykatës apo prokurorisë të vonojë regjistrimin e çështjes së caktuar dhe sipas preferencës ta dërgojë tek gjyqtari apo prokurori i caktuar. Pra një lëndetë dorëzuar i ndërrohet radha dhe varësisht çift apo tek i caktohet gjyqtarit apo prokurorit i cili synon ta ketë atë lëndë. Po ashtu edhe sistemi i caktimit të lëndëve nga kryetari i gjykatës, i jep mundësi të njëjtit që lëndët t'i ndaj sipas interesave të tij. Kjo është në kundërshtim me principet themelore të punës së sistemit gjyqësor, i cili kërkon pavarësi të plotë dhe paanshmëri e objektivitet. Si shembulli më i keq që përdoret në raportin e EULEX janë rastet kur edhe pas caktimit të rasteve gjyqtarët i ri-caktojnë dhe i rishpërndajnë rastet në mes veti.

Gjatë intervistës së zhvilluar me Kryeprokuroren e Shtetit z. Hilmi Zhitija, ai pranon se me sistemin aktual të ndarjes së lëndëve ka mundësi për manipulime të tilla. Mirëpo, përpos që mund të ndodh që lëndët të ndahen dhe të merren sipas preferencës së vetë

² EULEX Report Programme – July 2009

prokurorëve, në raste më të rënda mund të ndodh edhe zhdukja apo fshehja e lëndës. Për zhdukje të lëndëve, z. Zhitija thotë se është shumë e vështirë të bëhet pasi lënda qysh në fillim regjistrohet dhe evidentohet dhe kurdoherë mund kërkohej përgjegjësi për të, për më tepër ai nuk ka ndonjë informacion që të ketë ndodhur zhdukje e lëndëve në institucionin që drejton. Sa i përket fshehjes së lëndëve, Kryeprokurori i Shtetit pohon se vetë ai ka pasur rast të tillë kur i ka gjetur një prokurori një lëndë shumë të ndjeshme të fshehur në sirtarë.

Në mos-efikasitetin e sistemit gjyqësor ndikim të madh ka edhe mënyra e menaxhimit të rasteve në procedurë. Është i njohur fakti se në Kosovë tej zgjaten procedurat gjyqësore, e madje në disa raste të kontesteve civile që ka pasur Qendra për Avokim dhe Këshilla Ligjore (QAKL) procedurat zgjasin deri në 10 vite deri në një aktgjykim përfundimtar. Procedura tjera që zgjasin janë edhe ato të trashëgimisë. Përderisa në njërin anë janë të pranishme këto tejzgjatje, në anën tjetër ekzistojnë palë të cilave të njëjtat konteste civile e trashëgimore u përfundohen brenda pak ditëve ose javëve. Për këtë shkak lindin edhe dyshimet e bazuara për keqpërdorime e korrupsion.

Rezultatet e mungesës së një mënyre objektive e transparente të ndarjes së rasteve dhe menaxhimit të tyre në procedurë (sistem kompjuterik që veçse ekziston, por nuk implementohet) shihen nga Raporti i BIRN³, më konkretisht efikasitetin e disa gjykatësve në Gjykatën e Qarkut Pejë:

Emri i gjykatësit	Numri i rasteve të zgjidhura për një muaj
Esat Shala	99 raste të zgjidhura
Sudan Gorani	0 raste të zgjidhura
Ukë Muqaj	17 raste të zgjidhura
Muharrem Shala	23 raste të zgjidhura

Tabela 4. Efikasiteti i gjykatësve në Gjykatën e Qarkut në Pejë.

Lidhur me këtë lind një pyetje, se si është e mundur që një gjyqtar të jetë në gjendje të zgjidh 99 raste për një muaj derisa tjetri asnjë lëndë të vetme, apo gjyqtarët tjerë me 17 e 23 lëndë? Si caktohet radha e gjykimeve dhe si është e mundur që një qytetari një kontest të mos i zgjidhet për vite të tëra ndërsa tjetrit brenda pak ditëve? Pra këtu, për këto shkaqe edhe lindin mekanizmat për keqpërdorim ku për shkak të nevojës që një procedurë të kryhet më shpejtë qytetarët vihen në pozitë të kërkojnë zgjidhje tjera si të paguajnë mito ose të përdorin lidhje familjare e shoqërore.

Zgjidhja më e mirë do të ishte përdorimi i Sistemit Informativ të Menaxhimit të Lëndëve. Përmes përdorimit të këtij sistemi do të bëhej automatizimin e funksionimit të punës në të gjitha gjykatat. Ndarja e rasteve përmes këtij sistemi elektronik do të

³ Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese – “Monitorimi i Gjykatave”, Qershor 2009

bëhej sipas probabilitetit dhe në mënyrë automatike, pa mundësi të ndërhyrjes nga personat e interesuar. Për më tepër edhe menaxhimi dhe fazat e procedurës do të mund të përcilleshin lehtë përmes kësaj mënyre. Ky sistem e bën shumë më të lehtë këtë përcjellje e po ashtu gjyqtarët do të mund të thirreshin në përgjegjësi për mos respektimin e radhës së shqyrtimit të lëndëve.

Megjithëse Sistemi Informativ i Menaxhimit të Lëndëve ekziston, dhe për më tepër që në Prill 2009 Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian ka instaluar 616 kompjuterë të rinj me programin përkatës pikërisht për zbatimin e këtij sistemi, ky sistem ende nuk aplikohet në punët e gjykatave tona.

3. Procedimi i lëndëve lidhur me korrupsionin

Në përgjithësi opinioni publik nuk është i kënaqur me rezultatet e deritanishme të luftës kundër korrupsionit dhe korrupsionin e shohin si një dukuri shumë të përhapur. Kjo vërtetohet edhe me rezultatet e Barometrit Global të Korrupsionit 2009 (Transparency International) ku vërehet një shkallë e lartë e përhapjes së korrupsionit, dhe në shumë sektorë edhe rritje e shkallës së korrupsionit në krahasim me vitin 2007. Nga shkalla 1 që paraqet një vend pa prezencë të korrupsionit, e deri në shkallën 5, që paraqet nivelin ekstrem të korrupsionit, në Kosovë kemi këto rezultate:

	<i>Partitë Politike</i>	<i>Parlamenti</i>	<i>Sektori Privat</i>	<i>Media</i>	<i>Shërbyesit civilë</i>	<i>Gjyqësori</i>
2007	3.8	3.5	3.1	2.5	/	3.5
2009	3.8	3.4	3.7	2.3	3.3	4.0

Tabela 5. Niveli i korrupsionit në Kosovë sipas sektorëve (Marrë nga Global Corruption Report 2007 dhe 2009)

Element që përdoret për matjen e korrupsionit është edhe përqindja e qytetarëve që kanë paguar mito në 12 muajt e fundit, instrument i zhvilluar nga Transparency International (TI) që përdoret në Barometrin Global të Korrupsionit. Sipas TI në Kosovë 13% e qytetarëve kanë paguar mito në 12 muajt e fundit për kryerjen e shërbimeve të ndryshme ose favoreve. Ky rezultat është shumë shqetësues, sidomos kur rezultate të ngjashme kemi në vendet si Bjellorusia me 13% e Nigeria me 17%, derisa vendet e Bashkimit Evropian sikurse Danimarka, Holanda e Zvicra kanë vetëm 1% të qytetarëve që paguajnë mito. Po ashtu edhe vendet e rajonit kanë shifra shumë më të ulëta, si Kroacia me 4%, Maqedonia me 4% e Turqia me vetëm 2% të qytetarëve që kanë paguar mito në 12 muajt e fundit.

Gjithashtu edhe anketimet e bisedat direkte të zhvilluara me qytetarë nga ana e Qendrës për Avokim dhe Këshilla Ligjore flasin për pakënaqësi të mëdha sa i përket rezultateve

në luftë kundër korrupsionit.

Një prej çështjeve shumë të debatuar dhe për të cilën hidhen akuza nga të gjitha institucionet përgjegjëse në adresë të njëra tjetrës janë pikërisht çështjet të cilat lidhen me suksesin në luftën kundër korrupsionit dhe dënimin e kryerësve të veprave të tilla.

Agjensioni Kosovar Kundër Korrupsionit (AKK) si një prej mekanizmave përgjegjës për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit është institucion i pavarur i formuar me Ligjin Kundër Korrupsionit shpallur nga Kuvendi i Kosovës më datë 22 Prill 2005. AKK-ja ka funksion në procedimin e rasteve të dyshuara në prokurori për procedim të mëtejme penal. AKK-ja gjatë vitit 2007 dhe 2008 ka dërguar në prokurori 100 raste dhe sipas Mentor Borovcit, Drejtor i Departamentit për Strategjinë Anti-korrupsion dhe Hetime Administrative shumë pak prej tyre janë kryer me sukses duke mos dhënë shifra konkrete. Po ashtu, sipas Borovcit problemet në prokurori kanë të bëjë me numrin e vogël të prokurorëve dhe gjyqtarëve, kushteve jo të mira, ndërhyrjet nga jashtë dhe korrupsioni brenda këtyre institucioneve.

Borovci pohon që problemi kryesor që kanë në raport me prokuroritë gjegjëse është mos procedimi i këtyre rasteve përkundër shumë fakteve të gjetura nga AKK-ja gjatë hetimeve. Për më tepër ai deklaron se në shumë raste AKK-ja ka gjetur prova bindëse për ekzistimin e korrupsionit, por të cilat prova nuk janë trajtuar nga prokuroria si duhet. Tashmë AKK-ja ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me EULEX dhe një sërë çështjesh veçse iu janë drejtuar EULEX.

Sipas teorisë juridike, Kodi i Procedurës Penale parasheh që të gjitha të gjeturat të cilat mund të përdoren në cilësinë e provës gjatë gjykimeve, po ashtu parasheh edhe organet përgjegjëse për mbledhjen e provave. Në anën tjetër Kryeprokurori i Shtetit z. Hilmi Zhitija duke elaboruar legjislacionin aktual, sqaron mungesat me ndikim direkt në procedimin e lëndëve anti-korrupsion. Sipas Kryeprokurorit të Shtetit ky Kod nuk e njeh Agjensionin Kundër Korrupsionit si organ përgjegjës për mbledhjen e provave. Prandaj, të gjitha të gjeturat e AKK-së, prokurorisë i shërbejnë vetëm si elementë për të filluar hetimet, e kursesi si prova. Pra, nëse prokuroria në materialet e siguruar nga AKK-ja gjenë elemente të korrupsionit rishtas duhet filloj hetimet që nga fillimi, gjë që rezulton me një punë të dyfishtë nga ana e institucionit.

Sa i përket hetimeve të bëra nga ana e vetë prokurorisë për numrin e madh të rasteve të dërguara nga ana e Agjensionit Anti-Korrupsion dhe rasteve tjerat të dyshuara të korrupsionit, zoti Zhitia deklaron se ka mungesa të mëdha të kapaciteteve. Kështu për shumë lëndë, ai deklaron se është e nevojshme të bëhen hetime në nivel ekspertësh nga ana e Policisë për Krime Ekonomike, dhe se aty lëndët nuk kthehen me nga 2 vite. Në rastet më të rënda ai pohon se punonjësit e Policisë për krime Ekonomike në momentin kur kanë shkuar të zhvillojnë hetime në kompani si Posta dhe Telekom

Kosovës, KEK-u janë joshur me paga shumë më të larta dhe kanë lënë punën në Polici për tu punësuar në ato institucione.

4. Roli i prokurorive në seancat gjyqësore dhe rezultatet e tyre

Prokuroria është organ themelor në fazën e hetimeve paraprake. Prokuroria mund të kryej çfarëdo veprimi, që është i paraparë edhe me Kodin e Procedurës Penale, i cili është i nevojshëm për të vërtetuar ekzistimin dhe autorin e veprës penale. Pra, prokuroria paraprakisht bën përgatitjen e çështjes, provave dhe e dërgon për procedim në gjykatë. Në një formë nga vetë puna e prokurorisë, administrimit të provave nga ana e saj, varet edhe shpallja e dënimeve meritore nga ana e gjykatës.

Shumë elemente ndikojnë në një efikasitet, objektivitet dhe profesionalizëm të prokurorisë, por këtu do të ndalemi vetëm tek bashkëpunimi institucional polici-prokurori, krijimi i policisë gjyqësore, dhe krijimi i njëjve të specializuara nga ana e prokurorisë.

Gjetja e parë është se nuk ka një kontinuitet të përcjelljes së një rasti nga i njëjti prokuror. Pra, njëri prokuror i zhvillon hetimet, tjetri i merr pjesë në procedurën paraprake, tjetri në shqyrtimin kryesor. Kjo padyshim se është një gjetje negative për arsye se nëse prokurorët ndërrohen në të njëjtin rast edhe argumentimi i çështjes në gjykatë do të jetë me i dobët për shkak të përcjelljes së tërë informatave lidhur me rastin nga njëri prokuror tek tjetri dhe mënyrës së administrimit të provave.

Në njërën anë edhe roli i policisë është i madh në hetimin dhe zbulimin e veprave penale, madje pjesë të tëra të hetimeve kryhen nga vetë policia, e kjo duhet të ndodh nën autorizimin dhe direktivat e prokurorit. Mirëpo pikërisht këtu paraqitet një problem, pasi në shumicën e rasteve prokurorët nuk dalin fare në vendin e ngjarjes dhe të gjitha veprimet kryhen vetëm nga policia.

Në intervistën e zhvilluar me gazetaren e “Express” Selvije Bajrami, e cila mbulon fushën e drejtësisë, ofrohen informacione mbi kushtet e rënda me të cilat ballafaqohen prokurorët e Kosovës të cilët nuk kanë siguri të mjaftueshme, pagesa të dobëta dhe nuk u paguhen as shpenzimet e udhëtimit për në vendin e ngjarjes, dhe në rastet më të rënda u ndodh shpesh që për tek vendi i ngjarjes të udhëtojnë së bashku me familjarët e viktimave.

Në Kosovë sipas rregullativës ligjore parashikohet të krijohet policia gjyqësore që do të kishte për mision kryerjen e hetimeve kur i besohen nga ana e prokurorit. Fatkeqësisht kjo strukturë ende nuk është krijuar dhe nuk është funksionale edhe pse është planifikuar për një kohë të gjatë. Momentalisht funksionin e policisë gjyqësore e kryejnë njësitë e hetuesisë pranë Policisë së Kosovës.

Sipas EULEX bashkëpunimi institucional polici-prokurori dhe krijimi i njësive të specializuara nga ana e prokurorisë paraqesin mangësi në prokurorinë e Kosovës. Ata kanë gjetur se asnjë Zyrë e Prokurorisë nuk ka njësi të veçanta për luftimin e llojeve të caktuara krimeve, me përjashtim të një prokurorie të Qarkut që ka një prokuror të specializuar për rastet e armëmbajtjeve pa leje. Specializimi është mëse i nevojshëm duke filluar nga prokurorët anti-korrupsion dhe të krimeve ekonomike, për të mitur, armëmbajtjeve pa leje, vrasje dhe fusha tjera. Kjo duke u bazuar në nevojën për specializim në këto fusha për shkak të strukturës së tyre komplekse.

Po ashtu, shqetësuese mbetet gjetja e EULEX për mosbashkëpunim në nivel institucional në mes të policisë së Kosovës dhe Prokurorisë. Bashkëpunimi në mes këtyre institucioneve bëhet në baza të përkohshme për raste të caktuara. Nuk ka bazë institucionale të bashkëpunimit dhe të diskutimit të përbashkët të rasteve në mes të Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë. Ky bashkëpunim institucional besohet se do të ndikonte në ndërtimin më të mirë të rasteve që dërgohen për procedim në gjykata nga ana e prokurorisë.

Në këto dy çështje Kryeprokurori i Shtetit z. Hilmi Zhitija arsyeton se është i vetëdijshëm për nevojën e specializimit të prokurorëve, por me kapacitete aktuale ky specializim është i pamundshëm. Numri aktual i prokurorëve sipas tij është rreth 60. Gjithashtu edhe për sa i përket bashkëpunimit institucional me policinë, ai prapë arsyetohet me numër të vogël të prokurorëve dhe mungesë të kohës për prokurorët për kooperim me policinë pasi ata duhet të jenë në seanca të zhvillojnë hetime etj.

Tejzgjatja e disa procedurave të ndjeshme dhe me interes për publikun, mos gjetja e autorëve të veprave penale, e në disa raste edhe lirimi i disa personave të dyshuar ka ndikuar në besueshmërinë shumë të ulët të tërë sistemit të drejtësisë në Kosovë. Gjyqësia në Kosovë sot radhitet si njëra ndër institucionet me besueshmërinë më të ulët sipas Raportit të Parajlmërimit të Hershëm nga UNDP, apo si institucioni më i korruptuar në Kosovë sipas Transparency International.

5. Profesionalizmi i gjyqtarëve

Nga këndi i shoqërisë civile nuk është i mundur të bëhet vlerësimi i profesionalizmit të gjyqtarëve dhe punës së gjykatave. Për më tepër, është e vështirë të thuhet nëse kemi të bëjmë me shkelje me qëllim përfitimi apo lëshime për shkak të mos-dijes. Profesionalizmi i gjykatave është pikë shumë e ndjeshme, kontrolli i së cilës duhet bërë nga ana e organit më të lartë kontrollues të gjykatave. Ky organ në Kosovë është Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), më konkretisht Komisioni për Administrimin e Gjykatave që funksionon në kuadër KGJK-së. Mirëpo një komision i tillë është jo-funksional për një kohë të gjatë dhe asnjëherë nuk ka bërë një vlerësim të tillë.

Për një vlerësim të tillë të profesionalizmit të gjyqtarëve do të përdorim katër kritere të tërthorta: rezultatet e gjyqtarëve në testin e etikës gjatë procesit të ri-emërimit të gjyqtarëve, të dhënave statistikore mbi kthimin e lëndëve në rigjykim, ankesat e qytetarëve në QAKL dhe mënyra të vendosjes lëndëve që lënë hapësira të mëdha për dyshime.

Procesi i ri-emërimit të gjyqtarëve bëhet nga ana e Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGJP), që është trup autonom në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK). Qëllimi i KPGJP-së është kryerja e një rishikimi gjithëpërfshirës, në tërë Kosovën, mbi përshtatshmërinë e kandidatëve, gjyqtarëve ekzistues dhe aspirantëve për pozitën e gjyqtarit dhe prokurorit që janë parashtrues të kërkesave për emërim të përhershëm në këto pozita. Në kuadër të kësaj përzgjedhje këta kandidatë i janë edhe një testi të etikës. Ka qenë shqetësues fakti që një numër jo i vogël i gjyqtarëve dhe prokurorëve me një karrierë të gjatë në sistemin e drejtësisë në Kosovë kanë rënë pikërisht në këtë test bazik. Kjo lë shumë hapësira për të dyshuar edhe në vetë punën e tyre gjatë kohës sa kanë shërbyer në sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Fakti i dytë në bazë të së cilit do testohet profesionalizmi i gjyqtarëve të sistemit të drejtësisë në Kosovë është numri i lëndëve që kthehen në rigjykim për shkak të shkeljeve. Në teorinë juridike një lëndë kthehet në rigjykim nga gjykata e shkallës së dytë kur ka lëshime dhe gabime në marrjen e aktgjykimit nga ana e gjykatës së shkallës së parë, gjë që ka ndikuar direkt në një aktgjykim të tillë. Lëndët civile janë lëndët lidhur me të cilat paraqiten ankesat më të mëdha për shkelje në tejjzgjatjen e procedurave. Po sipas statistikave të EULEX, 43.6% të rasteve të përfunduara në konteste civile janë raste tek të cilat gjykata e shkallës së dytë ka anuluar vendimin e shkallës së parë dhe i ka kthyer në rigjykim për shkak të shkeljeve dhe lëshimeve.

Rast tjetër ilustrues ka dhënë edhe Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës Z. Zhitija i cili na njofton me një rast të ndjekjes penale nga ana e prokurorisë publike ku shkalla e parë dhe e dytë të pandehurin e shpallin të pafajshëm derisa duhet që lënda të shkojë në Gjykatën Supreme që personi i akuzuar të shpallet i fajshëm dhe të dënohet.

Çështje shqetësuese në opinin paraqet edhe zgjidhja e ndryshme në raste të njëjta. Ende Gjykatat në çështje civile, penale e administrative nuk kanë krijuar një praktikë të njëjtë të vendimmarrjes për raste afërsisht të njëjta. Aq më keq, ekzistojnë raste praktike kur për çështje të njëjtë tek palët e ndryshme vendimet janë kontradiktore me njëra tjetrën. Gazetarja Selvije Bajrami nga gazeta “Express”, po ashtu ofron shembuj ilustrues të vendimeve gjyqësore që lënë hapësira të mëdha për të dyshuar. Sipas gazetares në fjalë, nga dy raste që ka monitoruar, njëri person është dënuar me 2.5 vite burgim për vjedhjen e një kasetofoni, derisa një person tjetër për trafikimin e tri femrave është dënuar me 7 muaj burgim.

Po ashtu edhe vetë ankesat e qytetarëve janë shumë të mëdha lidhur me profesionalizmin e gjyqtarëve dhe sjelljet e tyre. Përpos ankesave për ofendime, telefonata gjatë gjykimeve, ata flasin edhe për shkelje të qëllimshme dhe të paqëllimshme që drejtpërdrejtë ndikojnë në vendimin përfundimtar. Kështu, në QAKL ka pasur raportime për keqpërdorim të lidhjeve familjare me gjyqtarin, gjë që ka pasur efekt në vendimin e marrë.

6. Rregullsia e mbajtjes së seancave gjyqësore

Nga raportet e organizatave që merren direkt me monitorimin e punës së gjykatave në Kosovë, por edhe nga raporti i Qendrës Për Avokim dhe Këshilla Ligjore (QAKL) mbi rastet e korrupsionit dhe të dhënat që qytetarët japin në këtë qendër lidhur me rrjedhat e procedurave gjyqësore rrjedh përfundimi se kemi të bëjë me parregullsi shumë të mëdha dhe një kaos të vërtetë në mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore në Kosovë. Shkeljet më të shpeshta, që ka gjasa të jenë apo jo të implikuar në afëra korruptive, janë: ndërprerja e seancave për biseda në telefon ku palët dyshojnë për “pazarlëqe”, ofendimet personale, respektimi i kodit të veshjes, përdorimi i duhanit, mbajtja e seancave në zyra, mosrespektimi i kohës së fillimit të seancave etj.

Në kuadër të programit të Qendrës Për Avokim dhe Këshilla Ligjore (QAKL), që ka komponentin e ofrimit të ndihmës ligjore falas për qytetarë, të shumtë kanë qenë ata që janë ankuar sa u përket ofendimeve me karakter personal nga ana gjyqtarëve. Në disa raste qytetarët kanë deklaruar se paraprakisht gjyqtari i lëndës edhe u ka kumtuar rezultatin se kanë humbur lëndën para se ajo të përfundojë.

Parregullsi ka edhe në respektimin e orarit të gjykimeve. Nga publikimi i BIRN “Monitorimi i Gjykatave” vërehet se nga totali i 513 gjykimeve që janë monitoruar, vetëm 188 raste kanë filluar në kohë, derisa 304 raste kanë filluar me vonesë dhe 21 prej tyre nuk janë mbajtur fare.

Po ashtu, mbajtja e gjykimeve në salla, përdorimi i telefonave mobil dhe duhanit janë raste mjaft të shpeshta. Sipas BIRN nga 513 gjykime të monitoruara 375 janë mbajtur në zyra edhe pse ka ndodhur që gjatë asaj kohe të ketë salla të zbrazëta. Një praktikë e tillë nuk është e dëshirueshme pasi që zyrat nuk mund të ofrojnë elementet bazike teknike për gjykim si, inçizimin e seancës, hapësirën e nevojshme, vendin e prokurorit, avokatëve e gjyqtarit, nuk ofrojnë kushtet për pjesëmarrjen e publikut etj. Përpos mbajtjes së këtyre gjykimeve në zyraato gjithashtu kanë qenë të shoqëruara edhe me përdorim të shpeshtë të telefonit dhe duhanit nga gjyqtarët. Në QAKL një qytetar ka raportuar për rastin e tij ku për shkak të kushteve të tij shëndetësore nuk mund të duronte një ambient të mbyllur me tym duhani dhe ka kërkuar nga gjyqtari që të ndërpresë pirjen e duhanit. Gjyqtari jo vetëm që nuk e kishte ndërprerë, por sipas qytetarit

edhe e kishte ofenduar edhe pse çështja ishte shumë e ndjeshme dhe me rëndësi të madhe për palën. Qytetari ishte i detyruar që për shkak të problemeve të tij shëndetësore të lëshoj seancën.

Probleme tjera vërehen edhe për sa i përket kodit të veshjes dhe kodeve tjera. Këtë e konfirmon edhe gazetarja Selvie Bajrami nga “Express”, duke deklaruar se pas tri viteve punë në përcjellje të gjykatave ka vërejtur mos respektim të kodit të veshjes e më interesant që pas tri viteve e ka parë çekanin e gjyqtarit për herë të parë dhe atë jo në sallën e gjykimit, por në korridor.

Në praktikë në sistemin e gjyqësisë së Kosovës shpesh haset edhe përdorimi i telefonave celularë gjatë seancave. Madje ka raste edhe të ndërprerjeve të seancës për shkak të bisedave telefonike. Kjo praktikë ka bërë që për më tepër qytetarët të dyshojnë dhe të raportojnë në QAKL për dyshime për korrupsion, duke parë në disa raste rëndësisë që i jepet telefonatës dhe ndryshimit të qëndrimit nga ana e gjyqtarit dhe fillimit të sjelljeve arrogante ndaj njëres palë.

KONTROLI NDAJ GJYQËSORIT

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)

Sipas rregullimit kushtetues, nenit 108 të Kushtetutës së Republikës Kosovës, institucioni me përgjegjësi të më të mëdha lidhur me sistemin gjyqësor në Kosovë është Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Përgjegjësi të këtij institucioni janë:

- KGJK si institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor në Kosovë (neni 108, pika 1 dhe 2, Kushtetuta Kosovës).
- KGJK është përgjegjës për inspektimin gjyqësor, administrimin gjyqësor, përpilimin e rregullave për gjykata në pajtim me ligjin, punësimin dhe mbikëqyrjen e administratorëve të gjykatave, hartimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit për gjyqësorin, përcaktimin e numrit të gjyqtarëve në secilin juridiksion dhe bën rekomandime për themelimin e gjykatave të reja. Themelimi i gjykatave të reja bëhet me ligj (neni 108, pika 5, Kushtetuta e Kosovës).

KGJK është themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/52 të datës 20 dhjetor 2005 Mbi Themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Këshilli Gjyqësor i Kosovës përpos që po përballet me kritika nga më të ndryshmet sikurse janë ndikimet politike, centralizimi i pushtetit, problem të madh e ka edhe funksionalizimin e tij. KGJK nuk është funksional që nga Janari 2009, dhe për më tepër ka pasur pauza në

funksionim e tij edhe në të kaluarën. Aktualisht KGJK-ja është duke funksionuar, por me përbërje të pakompletuar.

Fenomeni i ndërhyrjeve politike në emërime dhe në përgjithësi i politizimit të institucioneve që do të duhej të jenë të pavarura është prezent në shoqërinë tonë dhe përmendet në shumicën e raporteve përfshirë edhe Raportin e Progresit të Bashkimit European për vitin 2009. Shqetësime nga ana e EULEX ngriten edhe në Programme Report ku thuhet që “EULEX”-i ka vlerësuar se kapaciteti i KGJK-së për ta siguruar një gjyqësor të pavarur të Kosovës është brengosës për shkak të përbërjes së KGJK-së, i cili nënkupton një përfshirje të konsiderueshme të pushtetit politik në procesin e vendim marrjes”.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përbërja e Këshillit Gjyqësor të Kosovës është prej 13 antarëve të cilët emërohen në këtë mënyrë: Pesë(5) anëtarë janë gjyqtarë që zgjidhen nga ana e gjyqësorit, katër(4) anëtar i zgjedhin deputetët e Kuvendit të Kosovës, ku së paku 2 prej tyre janë gjyqtarë, dy(2) anëtarë i zgjedhin përfaqësuesit e pakicës serbe në Kuvendin e Kosovës, dhe dy(2) i zgjedhin përfaqësuesit e pakicave tjera po ashtu në Kuvendin e Kosovës. Pra, në tërësi nga trembëdhjetë(13) anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës tetë(8) zgjidhen nga forcat politike në Kuvendin e Kosovës. Kjo praktikë e Kosovës është në kundërshtim edhe me Rekomandimin e Këshillit të Europës Numër R(94) 12 që precizon se nuk duhet të ketë ndërhyrje nga pushtetet tjera në organin më të lartë që merret me emërimin dhe përzgjedhjen e gjyqtarëve, pra me organin që administron gjykatat.

Fushë tjetër ku adresohen kritika është centralizimi i pushtetit në organet më të larta menaxhuese, edhe për sa i përket sistemit gjyqësor si dhe atij prokurorial. As Gjykatat e as prokuroritë nuk kanë asnjë kompetencë për sa i përket emërimeve në staf të administratës dhe menaxhimit të resurseve financiare, bazuar në përfaqësuesit e po këtyre institucioneve. Lidhur me administrimin e gjykatave përgjegjës është Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Këtë situatë shumë mirë e ilustron Kryeprokurori i Shtetit z. Hilmi Zhitija, i cili pohon se edhe për shpenzimet lidhur me pjesëmarrjen në ndonjë seminar apo punëtori i duhet t’i kërkojë leje Sekretarit të Përhershëm në Ministrinë e Drejtësisë. Për më tepër, ai tregon se ka vite që kërkon edhe një zëdhënës për institucionin që ai udhëheq, por për shkak të pamundësisë së tij për të punësuar një zëdhënës ende nuk e ka një të tillë. Sa i përket emërimeve në stafin e administratës, zoti Zhitija shton se institucioni i tij madje nuk konsultohet fare madje as tek pranimit i praktikantëve.

2. Vlerësimi i punës së gjyqtarëve

Element kyç për të analizuar funksionimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë dhe hapi i parë para se të fillohet me procedurat e rekrutimit të gjyqtarëve të rinj do të duhej të ishte përcaktimi i kritereve në bazë të të cilave do të bëhej monitorimi i punës së gjykatësve. Kjo pasi efikasiteti i punës së gjykatave nuk varet vetëm nga numri i gjyqtarëve por kriter me shumë rëndësi është monitorimi i punës tyre dhe një sistem i përgjegjësive.

Kompetencë për zhvillimin e kritereve për vlerësimin e punëve të gjykatave ka Këshilli Gjyqësor i Kosovës, përkatësisht Komisioni për Administrimin e Gjykatave. Megjithëse një mekanizëm i tillë do të duhej të funksiononte, bazuar në kërkimet e QAKL-së, asnjë vlerësim i tillë i punës së gjyqtarëve nuk është bërë deri më tani.

Të gjeturat e kësaj analize tregojnë se qfarë efekti negativ kanë mungesa e një kontrolli të tillë se sa probleme i shkakton sistemit gjyqësor si tërësi. Vetëm fakti se 43.6% e lëndëve të kontesteve civile të përfunduara janë kthyer në rigjykime për shkak të shkeljeve të gjyqtarëve tregon pa-përgjegjësinë e tyre dhe është njëri prej treguesve për grumbullimin e lëndëve dhe tejzgjatjen e procedurave. Po ashtu fakti se një gjyqtar në Gjykatën e Pejës zgjidh 99 raste derisa tjetri zero ose një tjetër 17 lëndë tregon se në mungesë të një sistemi të tillë gjyqtarët punojnë sipas dëshirave të tyre gjë që paraqet edhe një faktor tjetër në mos-efikasitetin aktual të sistemit të drejtësisë.

Nga mungesa e një sistemi kritereve të vlerësimit të punës së gjyqtarëve rrjedh edhe një çështje tjetër, ajo e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve. Pa u thelluar më tepër, nisur nga fakti se që nga pas lufta e deri më tani nuk është bërë asnjë vlerësim i punës së gjyqtarëve rrjedh se edhe ngritjet në detyrë nuk bëhen bazuar në principe të caktuara në bazë të rezultateve të arritura. Për më tepër edhe kjo lë mjaft hapësira për emërimet të larta në bazë të ndikimeve politike, lidhjeve familjare e shoqërore etj.

3. Deklarimi dhe kontrolli i pasurisë

Një prej mjeteve për të parandaluar korrupsionin në sistemin e drejtësisë në Kosovë është edhe deklarimi i pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në Kosovë ka pasur shumë akuza për krijimin e pasurive në vlera të mëdha nga ana e gjyqtarëve. Edhe në debatin televiziv “Jeta në Kosovë” ka pasur akuza në mes të Kryetarit të Gjyqit të Qarkut në Prishtinë, zotit Anton Nokaj dhe avokatit Tomë Gashi për pasuri milionëshe të krijuara përmes korrupsionit në sistemin gjyqësor.

Megjithëse ka shenja pozitive sa i përket rregullimit nga kjo lëmi, duhet pasur parasysh

se përpos deklaramit është e nevojshme që të bëhet edhe verifikimi i prejardhjes së pa-surisë.

TRANSPARENCA

Gjyqësia dhe prokuroria njihen si institucione me transparencë tejet të ulët. Për më tepër prokuroria njihet si institucioni më i mbyllur për publikun sipas një publikimi të dy organizatave jo-qeveritare në Kosovë, YIHR dhe Lëvizjes FOL. Transparenca e institucioneve përpos që ndikon në një besueshmëri më të madhe të qytetarëve dhe bashkëpunim më të madh të tyre, efektin tjetër pozitiv e ka edhe në ndikimin e qytetarëve dhe ekspertëve në kontrollin e punës dhe praktikatat e tyre për rezultate më të mira.

Komunikimi me institucionet e sistemit drejtësisë në Kosovë në përgjithësi është shumë i vështirë si për qytetarët e thjeshtë ashtu edhe për gazetarët. Kështu, Selvie Bajrami deklaroi se asnjë prej institucioneve si gjykatat, prokuroritë, Instituti Gjyqësor i Kosovës nuk kanë zëdhënës dhe ka shumë probleme në komunikim me këto institucione.

Shumë pak gjykime praktikojnë vendosjen e tabelave informuese në hyrje të gjykatave me anë të të cilave do të informohej publiku lidhur me shpalljen e kohës së gjykimeve, ndarjen e rasteve mes gjyqtarëve etj. Për më tepër Gjykatat dhe prokuroritë nuk kanë faqe elektronike ku do të vendosnin materiale të ndryshme informuese për publikun apo edhe shpalljen e kohës së gjykimeve e shumë informata tjera që nuk do të preknin privatësinë e palëve.

Një element tjetër i transparencës dhe rritjes së besimit të qytetarëve në këto institucione është edhe vendosja e marrëdhënieve të afërta e njerëzore me qytetarët. Mirëpo, si administrata e gjykatave dhe prokurorive ashtu edhe vetë gjyqtarët e prokurorët karakterizohen me sjellje mjaft të ashpra në drejtim të qytetarëve. Në QAKL ka pasur raste të shumta kur qytetarët deklarojnë për ofendime nga më të ndryshmet vetëm pse kanë kërkuar një informatë apo kanë shkuar të pyesin për rastin e tyre, procedura e të cilit rast është zgjatur shumë. Ky është edhe një nga faktorët se pse sistemi i drejtësisë ka besueshmëri kaq të ulët.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve

Aktualisht në Kosovë ankesat e qytetarëve lidhur me rastet e tyre që janë në gjykim diskutohen me Kryetarët e Gjykatave. Kjo praktikë nuk është prej më të mirave për arsye se shkel parimet e paanshmërisë dhe pavarësisë. Lidhur me këtë praktikë ka pasur ankesa edhe në QAKL-ë, ku qytetarët duke mos parë zgjidhje për ankesat dhe prob-

lemet e tyre deklarojnë se të gjithë janë një trup i vetëm.

Sipas “Programme report” të EULEX në asnjë prej regjioneve të Republikës së Kosovës, as Këshilli Gjyqësor i Kosovës, e as Inspektorati Gjyqësor nuk kanë zyre apo përfaqësues për të mbledhur ankesate qytetarëve nga ai regjion, mirëpo këto zyre janë të koncentruara vetëm në Prishtinë. Në rast të ankesës së një qytetari, supozojmë nga regjioni i Pejës apo Gjilanit, ankesa duhet të parashtrohet në Prishtinë.

PËRFUNDIM

Sistemi i gjyqësisë, tashmë ka kaluar suazat e shqetësimit të nivelit vendor. Kjo temë është bërë fokus i raporteve nga më të ndryshmet, si vendore, po ashtu dhe ato ndërkombëtare. Ndërlidhjet që i bëhen këtij sistemi në analizat e mekanizmave të ndryshme ndërkombëtare, reflektojnë gjendjen e rëndë.

Mangësitë që reflektohen në funksionimin e sistemit gjyqësor adresohen vazhdimisht, ndërkohë, masat konkrete për ta përmirësuar gjendjen nuk vërhen askund. Mungesa e përvojës, vullnetit politik dhe resurseve për të bërë më shumë në fuqizimin e një prej shtyllave më të rëndësishme të shtetit ligjor, po karakterizohet me pengesa në forcimin e shtetit.

Bazuar në standardet demokratike, vendi ynë ballafaqohet me shumë mangësi në përmbushjen e obligimeve dhe standardeve që garantojnë ndërtimin e një shteti ligjor. Kjo është duke reflektuar me rritjen e korrupsionit dhe rënien e imazhit dhe besimit të punëtorëve të drejtësisë.

Është domosdoshmërisht e nevojshme që organet e drejtësisë, të kryejnë misionin e tyre karshi mandatit që kanë. Përmbushja e infrastrukturës ligjore, shmangia nga ndikimet politike, luftimi i korrupsionit, respektimi i normave dhe rregullave procedurale, janë disa nga sfidat që duhet të merren seriozisht nga institucionet.

Ministria e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor, Prokuroria dhe Gjykatat, vlerësohet se kanë mangësi në bashkëpunimin e ndërjellët. Në këtë sferë, përfshirja e EULEX-it, duhet kuptuar si mbështetje dhe shtytje e mirë për ta fuqizuar drejtësinë në vend.

Sistemi juridik në vend vazhdon të funksionoj i bazuar në sistemin juridik të kaluar, duke mos i respektuar normat dhe standardet demokratike. Mbi të gjitha, është konstatim i përgjithshëm se sistemi juridik në vend ka nevojë emergjente të reformimit dhe të rregullimit ligjor të të gjitha institucioneve të drejtësisë.

LITERATURA E PËRDORUR:

Raporti i Rasteve të Korrupsionit – Instituti Demokratik i Kosovës, Qershor 2009

Global Corruption Barometer – Transparency International, 2007

Global Corruption Barometer – Transparency International, June 2009

EULEX Programme Report – European Union Rule of Law Mission in Kosova, July 2009

Monitorimi i Gjykatave – Balkan Investigative Reporting Netëork

Early Warning report – UNDP, December 2008

Raporti gjashtë mujor 2009 – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Raporti gjashtë mujor 2009 – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kodi Penal i Kosovës

Kodi i Procedurës Penale

Raportet e OSBE mbi Sistemin e Drejtësisë në Kosovë

Raporti i Progresit i Komisionit European (2008, 2009)

Ligji mbi Noterinë

Rekomandimi Këshillit Europës Numër R(94) 12

Projekt-ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë

Intervistat me:

Hilmi Zhitija – Kryeprokurorë i Kosovës

Mentor Borovci – AKK

Selvije Bajrami – Gazetare

INDICATORS OF THE SPREAD OF CORRUPTION IN KOSOVO'S JUDICIAL SYSTEM



STAFF

Ismet KRYEZIU - Executive Director

email: ikryeziu@kdi-kosova.org

Vjollca VOGËL - Admin & Finance Manager

email: vjollca@kdi-kosova.org

Leonora CIKAJ - Admin & Finance Assistant

email: lcikaj@kdi-kosova.org

Albana HALIPI - Admin & Finance Assistant

email: ahalipi@kdi-kosova.org

